



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Dorezimi Prilimani / Prilidje Receipt / Delivery	29.03.2023	3	viti god Year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org. / Unit	SKIMSHUK	3124/2023	115
Nr. Prot. Pr. No		Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.351/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.351/2023 të datës 13.02.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në punë të datës 24.01.2023, në çështjen juridike “Vlerësim i Rezultateve në Punë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 29.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. SHFUQIZOHET formulari i vlerësimit të rezultateve në punë i ankuesit për vitin 2022 i datës 24.01.2023.
- II. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës ta *rishqyrtojë* rastin e ankuesit në pajtim me legjislacionin në fuqi, njëherit të bëjë *ri-vlerësimin* e rezultateve në punë.
- III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës dhe Udhëheqësi i Personelit, që t’i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesi është i punësuar në Komunën e Fushë Kosovës, sipas Akt Emërimit me numër 730 të datës 07.07.2016 në pozitën “Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm”, në kuadër të zyrës së Kryetarit të Komunës. Me datë 24.01.2022 Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë i ankuesit ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 duke e vlerësuar ankuesin me notën e Përgjithshme 1.24.

I pakënaqur me Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2022, ankuesi me datë 13.02.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1694/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit vjetor të punës për vitin 2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.02.2023 me numër protokoli 2136/2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Fushë Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 14.03.2023 me numër protokoli 2648/2023 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Fushë Kosovës me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 1694/2023 të datës 13.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Letërnjoftim i SH.K.; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i SH.K. i datës 24.01.2023; E-mail nga SH.K. për V.H i datës 23.12.2021; Plani Strategjik me numër protokoli 1128 i datës 22.12.2021; Plani Vjetor me numër protokoli 1129 i datës 22.12.2021; Plani Strategjik me numër protokoli 1152 i datës 22.12.2022; Plani Vjetor me numër protokoli 1153 i datës 22.12.2022; Raporti vjetor i punës dhe aktiviteteve të Njësia e Auditimit të Brendshëm për periudhën prej 01.01.2022 deri 31.12.2022; Raporti Auditimit për Komunën e Fushë Kosovës për vitin Financiar të përfunduar me 31 dhjetor 2018; Raporti i Auditimit për pasqyrat Financiare të Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2019; Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2021; Vendim me numër protokoli 967 i datës 10.06.2020; Vendim me numër protokoli 1516 i datës 15.10.2020; Raporti vjetor për vitin 2022 lidhur me Progresin për zbatimin rekomandimet të ZKA-së, nga raporti i auditimit të Komunës së Fushë Kosovës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2021, qershor 2022 nga Zyra Kombëtare , nr.577 datë 13.07.2022 i protokolluar me numër 85 i datës 31.01.2023; Raporti Progresit për zbatimin rekomandimet të ZKA-së, nga raporti i auditimit të Komunës së Fushë Kosovës për vitin financiar të përfunduar me 31 dhjetor 2021, qershor 2022 nga Zyra Kombëtare të Auditimit, nr.577 datë 13.07.2022 i protokolluar me numër 854 i datës 30.09.2022; E-mail nga SH.K. për M.I i datës 19.03.2019; Pyetësori i vetëvlerësimit të Komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin Janar 2018-Janar 2019; E-mail nga SH.K. për M.I. i datës 22.04.2021; Pyetësori i vetëvlerësimit të Komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit me numër protokoli 746 i datës 05.05.2020; Pyetësori i vetëvlerësimit të Komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit me numër protokoli 296 i datës 21.04.2021; Certifikatë e SH.K. me Nr./No. 05-04/36/21 i datës 31.12.2021; Pasqyra e arritshmërisë i datës 31.12.2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokoli 2136/2023 i datës 27.02.2023; Përgjigje në

ankesë me numër protokollit 2648/2023 i datës 14.03.2023; Pliko me numër R2901572 me numër protokollit 316 i datës 02.03.2023; Akt Emërim i SH.K. me numër protokollit 730 i datës 07.07.2016; E-mail nga SH.K. për N.F i datës 20.12.2022; E-mail nga SH.K. për N.F i datës 20.12.2022; E-mail nga SH.K. për M.K. i datës 31.01.2023; E-mail nga SH.K. për B.K. etj. i datës 20.12.2022; E-mail nga H.GJ. për C.Z. i datës 23.03.2023; E-mail nga C.Z. për H.GJ. i datës 23.03.2023; Vijueshmëria në punë e ankuesit për vitin 2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ekziston baza ligjore që lënda e ankuesit të kthehet në *rishqyrtim*, duke e obliguar Kryetarin e Komunës së Fushë Kosovës që të bëjë ri-vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 për ankuesin *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi sipas aktit të emërimit të datës 07.07.2016 mbanë pozitën "*Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm*" në kuadër të zyrës së Kryetarit të Komunës, ndërsa në bazë të formularit për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 me datë 24.01.2023 nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt është vlerësuar me notë 1.24 .

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë dhe besueshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022 nga Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë është bërë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik, në kërkesën për përgjigje në ankesë e protokolluar me numër:2136/2023 të datës 27.02.2023, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ndër të tjera, ka kërkuar: *Akt Emërimit e ankuesit; Përshkrimin e detyrave të punës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 24.01.2023; Dëshmi se a është mbajtur takim i përbashkët me mbikëqyrësin; Dëshmi lidhur me raportimin pranë Prokurorisë Themelore në Prishtinë ashtu siç ka pretenduar ankuesi; Dëshmi se a ka dorëzuar planet brenda afatit të paraparë për vitin 2022 me 22.12.2021 dhe për vitin 2023 me datë 22.12.2022; Dëshmi se a është ndërpre auditimi siç pretendon ankuesi; Raportin vjetor të datës 31.06.2023 nr. 340; Raporti nga zyra kombëtare e auditimit për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021; Vendimin e datës 15.10.2020; Dëshmi lidhur me raportimin çdo 6 muaj për gjendjet e rekomandime të ZKA dhe NJAB për MSA pranë zyrtarit përgjegjës të Komunës; Dëshmi lidhur me mbajtjen e tri takimeve të Komitetit Auditimit si dhe proceset e përpiluara; Dëshmi lidhur me kryerjen e punës së Kryetarit të Komisionit për Librin e proceseve dhe menaxhimin e rreziqeve për komunë në emër të Menaxhmentit për vitin 2021 dhe 2022; Plani vjetor dhe strategjik 2021 dhe 2022; Raporti vjetor 2022 I NJAB i datës 31.01.2023; Vendimi i koordinators të procesit për çështjet e zbatimit të rekomandimeve në përbërje prej 12 anëtarëve; Vendimi i Kryetarit të grupit punues për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut; Raporti I progresit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së 2019, 2022 dhe 2023; Vetëvlerësimin e komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për Komunë për vitin 2018, 2019 dhe 2021; Ndërsa Komuna e Fushë Kosovës përmes shkresës me numër protokollit 2648/2023 të datës 14.03.2023 të nënshkruar nga Zëvendësuesi i Udhëheqësit të Personelit, kanë kthyer përgjigje mirëpo nuk kanë arritur të dëshmojnë me fakte se cilat kanë qenë realisht objektivat punës së ankuesit për vitin 2022 për të cilat janë pajtuar ankuesi me udhëheqësin e tij siç përcaktohet me nenin 6 paragrafi 1, 3 dhe 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: "1. Brenda muajit Janar të vitit për të cilin bëhet vlerësimi i rezultateve në punë apo brenda tre (3) muajve të parë të emërimit të nëpunësit, mbikëqyrësi (vlerësuesi) së bashku me nëpunësin (i vlerësuar) përcaktojnë dhe pajtohen me objektivat dhe me*

planin e aktiviteteve për arritjen e objektivave të përcaktuara për vitin për të cilin vlerësohet; 3. Objektivat dhe plani i aktiviteteve për arritjen e objektivave përcaktohen me shkrim sipas afateve në paragrafin 1 të këtij neni dhe vendosen në formularin e vlerësimit (Formularin 1) si dhe shërbejnë si bazë për vlerësimin vjetor të nëpunësit. Formularin 1 është shtojcë dhe pjesë përbërëse e kësaj Rregullore. 4. Përcaktimi i objektivave, bazohet në objektivat e institucionit dhe në përshkrimin përkatës të punës së nëpunësit”.

Po ashtu Kolegji me përgjigjen e datës 14.03.2023 nuk ka pranuar fakte të provueshme se gjatë vitit kalendarik 2022 ankuesi të ketë pranuar ndonjë kërkesë nga udhëheqësi i tij më qëllim të rritjes së performancës, evitim të lëshimeve apo sugjerime në arritjen e objektivave, andaj mbi këtë bazë Kolegji ka konstatuar se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit nuk i ka përmbushur obligimet mbikëqyrëse siç përcaktohet me nenin 7 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi, së paku një herë gjatë periudhës vlerësuese dhe/ose sa herë që vlerëson të nevojshme, zhvillon takime me nëpunësin për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe sjelljet profesionale si dhe për dhënien e sugjerime për përmirësime të nevojshme”.

Kolegji ka analizuar formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të ankuesit për vitin 2022 i datës 24.01.2023 dhe ka gjetur se ankuesi për objektiva është vlerësuar me notë një pikë tridhjetë e shtatë (1.37) dhe po ashtu edhe për sjellje profesionale është vlerësuar me notë një (1), ndërsa nota e përgjithshme një pikë njëzet e katër (1.24), andaj lidhur me këto të gjetura Kolegji ka konstatuar se udhëheqësi i drejtpërdrejtë me rastin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin, respektivisht përcaktimit të notës mesatare nuk ka zbatuar më plotni udhëzimet e rregullores të përcaktuara si në nenin 10 paragrafi 1 dhe 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: “1. Vlerësimi për arritjen e objektivave të punës përbën 60% të rezultateve përfundimtare të vlerësimit, ndërsa vlerësimi i sjelljeve profesionale të nëpunësve civilë përbën 40% të rezultateve përfundimtare të vlerësimit; 4. Nota e përgjithshme kalkulohet duke mbledhur 60% (shumëzuar me 60 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të objektivave dhe 40% (shumëzuar me 40 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të aftësive”, andaj udhëheqësi i drejtpërdrejtë nuk ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 8 paragrafi 4 ku përcaktohet se: “ Formulari i vlerësimit siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni i dërgohet nëpunësit, i cili diskutohet në një takim me mbikëqyrësin dhe në afat prej 5 dite kalendarike nëpunësi duhet të shprehët (pajtohet ose nuk pajtohet) me vlerësimin e mbikëqyrësit”, pasi që Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit nuk ka arritur ta dëshmojë se ka vepruar në këtë mënyrë duke e njoftuar ankuesin me vlerësimin të paktën 5 ditë përpara se të përfundojë afati i fundit për vlerësime që sipas nenit 8 paragrafi 2 i së njëjtës rregullore është e përcaktuar: “Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin paraparak”.

Andaj pas vlerësimit të provave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, pas analizimit të dispozitave ligjore në fuqi, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe në bazë të gjeturave të pasqyruara si më lartë në këtë vendim. Kolegji ka ardhur në përfundimin se ekziston baza e mjaftueshme ligjore sikurse edhe fakte dhe prova konkrete se lënda e ankuesit duhet të kthehet në ri-shqyrtim me qëllim të ri-vlerësimit të ankuesit tek Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit pasi që i njëjti nuk ka arrit ta zbatojë në plotni nenin 43 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë ku përcaktohet se: “Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe

mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues", ku parashihet se vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm dhe zgjat për tërë vitin kalendarik në kuptim që nëpunësit të cilat nuk kanë performancë të mirë, apo sjellje jo të kënaqshme profesionale të këshillohen me sugjerimit e nevojshme për përmirësimin e performancës në kuptim të realizimit të objektivave të përcaktuara në fillim të vitit.

Kolegji, mbi bazën e asaj që u theksua si më lartë e ka shfuqizuar e formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të ankuese për vitin 2021 i datës 31.01.2022, ndërsa udhëheqësi i drejtpërdrejtë me rastin e ri-vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesen duhet t'i ketë parasysh të gjeturat në këtë vendim si dhe të vlerësojë ankuesen vetëm për objektivat e caktuara në fillim të vitit, parakushte këto të cilat nuk janë sqaruar mjaftueshëm me rastin e dërgimit të shkresës me provat e lëndës me datë 18.03.2022 dhe në mungesë të cilave Këshilli nuk ka mundur të vendos nëse ankuesja është vlerësuar drejtë dhe në mënyre meritore, ndërsa meqenëse pretendimi ankimor i ankueses se vlerësimi i bërë nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik është konstatuar si pretendim i qëndrueshëm në aspektin procedural të pasqyruar edhe në këtë vendim, prandaj lënda e ankueses kthehet në rishqyrtim me qëllim të ri-vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA A.nr.351/2023

Çlirim ZEKA

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Fushë Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.